



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

Nr. 06-29635/26
Klinë, datë: 10.09.2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i dhjetë publik për kornizen afatmesme buxhetore te vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e Komunës së Klinës, qytetit dhe lagjeve, Klinafc dhe Gjurgjevik i Vogel me, datë 04.09.2026, ora 10:00, Salla e Kuvendit Komuna Klinë.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 07/09/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve. Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i Draft-Buxhetit i vitev 2027-2029 i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft-buxheti edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuar.

Takimi ka nisur në ora 10:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, kryesuesi i kuvendit, nënkryetari komunes si dhe drejtor te drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te komunës së Klinës

Nga qytetarët morën pjesë 13 persona, prej të cilëve, 12 burra, dhe 1 grua.

Shtojca 10 – Fotografia nga dëgjim i dhjetë për kornizen afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret Komunes se Klinës,qytetit,lagjev Klinafcit dhe Gjurgjevik i Vogel i komunës së Klinës.



Takimi u hap nga Kryesuesi I Kuvendit Z.Enver Berisha"

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Berisha, hapi takimin duke i përshëndetur banorët e qytetit të Klinës, si dhe banorët e fshatrave Klinave dhe Gjurgjevik i Vogël. Ai përshëndeti të gjithë të pranishmit, në veçanti Kryetarin e Komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale.

Në fjalën e tij hyrëse, kryesuesi njoftoi të pranishmit se ky takim po mbahet në kuadër të dëgjimeve publike buxhetore, me qëllim të informimit të qytetarëve dhe marrjes së kërkesave dhe propozimeve të tyre lidhur me planifikimin e buxhetit komunal.

Pas këtij prezantimi, kryesuesi i kaloi fjalën Drejtorit të Financave, z. Faruk Smajli, për të vazhduar me prezantimin dhe informimin e të pranishmëve lidhur me procesin e planifikimit buxhetor.

Pas fjalës hyrëse të Kryesuesit të Kuvendit, fjalën e mori:

Drejtori i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, z. Faruk Smajli. Në fillim të fjalës së tij, Drejtori i Financave përshëndeti Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit Komunal, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët e Kuvendit, si dhe të gjithë qytetarët dhe të pranishmit në këtë dëgjim publik. Z. Faruk Smajli falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen dhe interesimin e tyre për procesin e planifikimit buxhetor të Komunës së Klinës. Ai theksoi se dëgjimet publike buxhetore janë një proces i rëndësishëm për përfshirjen e qytetarëve në përcaktimin e prioritetëve dhe projekteve që do të përfshihen në buxhetin komunal. Në vazhdim, Drejtori i Financave filloi prezantimin e Draft-Buxhetit të Komunës së Klinës, duke paraqitur në mënyrë të detajuar planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve për vitin e ardhshëm buxhetor, si dhe projeksionet buxhetore për vitet në vijim. Gjatë prezantimit, ai u ndal në strukturën e përgjithshme të buxhetit komunal, duke paraqitur ndarjet buxhetore sipas kategorive ekonomike dhe drejtorive komunale. Gjithashtu, sqaroi se planifikimi i buxhetit është bërë duke u bazuar në nevojat dhe prioritetet e Komunës, mundësitë financiare dhe kërkesat e paraqitura nga drejtoritë komunale. Në veçanti, u prezantuan planifikimet për investime kapitale dhe projektet që parashihet të realizohen në territorin e Komunës së Klinës, me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës, ofrimit të shërbimeve më të mira për qytetarët dhe zhvillimit ekonomik e social të komunës. Drejtori Smajli theksoi se në procesin e hartimit të Draft-Buxhetit janë marrë parasysh prioritetet e përcaktuara nga Komuna, nevojat e qytetarëve dhe kërkesat e drejtorive komunale, duke synuar që mjetet buxhetore të shfrytëzohen në mënyrë sa më efektive, transparente dhe në funksion të interesit publik. Në fund të prezantimit, z. Faruk Smajli ftoi qytetarët që të paraqesin kërkesat, sugjerimet dhe propozimet e tyre lidhur me Draft-Buxhetin, duke theksuar se kontributi i qytetarëve është i rëndësishëm në përcaktimin e prioritetëve dhe në përmirësimin e mëtejshëm të dokumentit buxhetor. Pas përfundimit të prezantimit të Draft-Buxhetit, Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për të pranishmit dhe u dha mundësinë qytetarëve që të paraqesin kërkesat dhe propozimet e tyre.

Diskutimet e pjesëmarrësve

Tunë Dedaj,Deiq

Përshëndetje të gjithëve. I nderuar Kryetar, të nderuar të pranishëm,
Kërkesa ime është përkatësisht për fshatin Deiq, për vazhdimin e trotuarit prej kishës, aty ku ka mbetur, si dhe për asfaltimin e një rruge në fshatin Videjë.

Pergjigja e Krytarit:

Faleminderit Tunë, Po ashtu, sa i përket rrugëve që kanë mbetur pa u asfaltuar, punimet tashmë kanë filluar dhe janë duke u shtruar pjesët e mbetura. Për këto projekte jemi në fazën përfundimtare të realizimit. Pra, kërkesat që u paraqitën janë të planifikuara dhe shumë shpejt pritet të përfundojnë edhe punimet në terren.

Arif Berisha,Gjurgjevik I Madhe

Kërkesa ime ka të bëjë me rrugën kryesore të fshatit, e cila lidhet me rrugën nacionale në Dollc. Kjo rrugë është dëmtuar si pasojë e qarkullimit të kamionëve me pesha të rënda dhe ka nevojë për intervenim dhe sanim.

Pergjigja e Kryetarit:

Faleminderit, Arif. Ne kemi planifikuar që këtë vit ta përfundojmë trotuarin në të gjithë fshatin, përfshirë pjesën ku ka mbetur pa u përfunduar, nga shkolla deri në fund të fshatit. Po ashtu, sa i përket rrugëve që janë dëmtuar, kemi planifikuar që gjatë vitit të ardhshëm të bëjmë sanimin dhe rregullimin e tyre.

Ragip Kryeziu,Klinë

Kërkesa ime ka të bëjë me rrugën që fillon nga zona e Interex-it dhe vazhdon deri në dalje të Klinës, tek ura do të doja të dija pse kjo pjesë e rrugës ende nuk është asfaltuar dhe kur parashihet të realizohet asfaltimi i saj.

Pergjigja e Kryetarit:

Rruga për të cilën e paraqitët kërkesën është në menaxhim të nivelit qendror dhe projekti për këtë rrugë ka filluar nga institucionet e nivelit qendror nga ana jonë, kemi adresuar disa kërkesa tek institucionet përkatëse, duke theksuar nevojën e madhe për intervenim dhe asfaltimin e kësaj rruge po ashtu, kemi kërkuar edhe takime me përfaqësuesit e nivelit qendror për të diskutuar nga afër për këtë çështje deri më tani, fatkeqësisht, nuk kemi marrë një përgjigje konkrete dhe positive megjithatë, shpresojmë që institucionet e nivelit qendror të intervenojnë sa më shpejt dhe të fillojnë realizimin e punimeve në këtë segment të rrugës.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryesuesi I Kuvendit deklaroi:

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.

Mirëmbetshi!"

Takimi u mbyll në ora 11:00

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	1
Burra	12
Totali	13

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu

